

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHA “UJËSJELLËS-KANALIZIME, QYTET”
SHKODËR, PËR PROJEKTIN “FURNIZIMI ME UJË DHE MBROJTJA
MJEDISORE E LIQENIT TË SHKODRËS”

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ujesjelles kanalizimet, qyteti Shkoder, per projektin “Fuqizimi me uje dhe mbrojtja mjedisore e liqenit te Shkodres”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga fillimi projektit deri me date 30.10.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 1055/6 prot., datë 13.03.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për oraganizimin dhe funksionimi e Kontrollit te Lartë të Shtetit”, me shkresën nr.1055/7, datë 13.03.2015 dërguar Z. Leonard Kepi, Drejtor i Shoqërisë dhe shkresën nr. 1055/8 datë 13.03.2015 dërguar Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Strukturat drejtuese të UKSh, nuk kanë ngritur njësinë e zbatimit të projektit, në kundërshtim me Kreun II të Marrëveshjes “Implementimi i Projektit”.

Titullarët e UKSH, nuk kanë përcaktuar personat përgjegjës dhe detyrat e secilit prej tyre që do të menaxhojnë financimet nga grandet, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të UKSH, të marrin masa të menjëhershme për të ngritur komisionet përkatëse për menaxhimin e financimit nga Grandet, duke përfshirë personelin inxhinieriko-teknik dhe atë financiar të shoqërisë, me qëllim pasqyrimin e saktë të të gjithë veprimtarisë dhe operacioneve të kryera që nga fillimi i projektit, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe punimeve të kryera.

Brenda muajit prill 2015

2. Dega e financës nuk disponon gjithë dokumentacionin financiar të projektit, por kryesisht janë të pasqyruara veprimet e pagesave të TVSH –së nëpërmjet Degës së Thesarit, Shkodër.

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të UKSh, të marrin masa për vënien në dispozicion degës së financës, gjithë dokumentacionin financiar, që nga fillimi i projektit deri në marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe punimeve të kryera.

Brenda muajit prill 2015

3. Dega e Financës, nuk ka mbajtur një sistem kontabël për veprimet financiare, referuar standardeve të kontabilitetit, ku të shënohen të gjitha operacionet e kryera dhe të identifikohen sendet pasurore dhe shërbimet e financuara, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, me ligjin nr. 10296, datë

08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për këtë rekomandojmë:

Dega e Financës, të pasqyrojë kronologjikisht të gjitha veprimet financiare që nga fillimi i projektit, ku të shënohen të gjitha operacionet e kryera dhe të identifikohen sendet pasurore dhe shërbimet e financuara.

Gjatë zbatimit të projektit

4. Certifikatat e pranimi të automjetit tip “Renault” dhe materialeve në shumën **26,705,411 lekë**, si edhe të 3 mjeteve të pastrimit dhe materialeve të furnizuara në shumën **75, 807,958 lekë**, janë nënshkruar nga ish drejtoresha znj. Sabahete Vidhaj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

Materialet nuk janë bërë hyrje me dokumentacionin e nevojshëm financiar, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III , pika 3 “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të shoqërisë dhe Dega e Financës, të marrin masa për kryerjen e veprimeve të magazinimit të materialeve të furnizuara nga projekti shoqëruar me automjetin tip “Renault” në vlerën 21,406,640 lekë, si dhe materialeve shoqëruar me 3 automjetet e pastrimit në vlerën 8,140,074 lekë, duke kryer më parë verifikimet sipas faturave dhe dokumentacionit shoqërues, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Strukturat drejtuese të shoqërisë dhe Dega e Financës, të marrin masa për kryerjen e veprimeve financiare, për pasqyrimin në inventar e marrjen në dorëzim të automjetit tip “Renault” me vlerë 5,298,771 lekë, dhe 3 mjeteve të pastrimit me vlerë 67,667,884 lekë, nga personat që i kanë në përdorim, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda muajit prill 2015

5. Në magazinën e UKSH, nga kontraktori....., është magazinuar një sasi mallrash të cilat nuk janë përdorur për kryerjen e punimeve, me vlerë **80,195,521 lekë**. Për këto materiale nuk janë kryer veprimet e magazinimit sipas dokumentacionit shoqërues, por ato mbahen në magazinë duke mos u kryer asnjë veprim hyrje/dalje, ose “mall në ruajtje”, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pikat 34, 37- 41 dhe 49.

Për këtë rekomandojmë:

-Strukturat drejtuese të shoqërisë dhe Dega e Financës, të marrin masa të menjëhershme për kryerjen e veprimeve të magazinimit, të materialeve gjendje në magazinë të kthyer nga kontraktorime vlerë 80,195,521 lekë, duke kryer më parë verifikimet sipas

faturave dhe dokumentacionit shoqëruës, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda muajit prill 2015

6. Materialet dhe pajisjet kompjuterike të furnizuara në shumën **7,217,858 lekë**, nuk janë bërë hyrje si edhe nuk janë kryer veprimet e dokumentimit të lëvizjes së aktiveve si edhe marrja në dorëzim nga personat që i kanë në përdorim, megjithëse furnizimet me këto pajisje datojnë në vitet 2009-2010.

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të shoqërisë dhe Dega e Financës, të marrin masa për kryerjen e veprimeve të magazinimit hyrje/dalje të materialeve dhe pajisjeve kompjuterike të furnizuara nga projekti në vlerën 7,217,858 lekë, si edhe marrjen në dorëzim të tyre nga personat që i kanë në përdorim, duke kryer më parë verifikimet sipas faturave dhe dokumentacionit shoqëruës, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda muajit prill 2015

7. Urdhri nr. 18, datë 29.06.2012, nxjerrë nga ish drejtoresha Sabahete Vidhaj, ku përcaktohet se të gjitha automjetet, të furnizuara në zbatim të kontratës “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kanalizimeve të ujërave të përdorura” të vihen në shfrytëzim sipas nevojave të ndërmarrjes dhe deri në momentin e përfundimit të projektit, vlera e këtyre aseteve të mbahet investime në proces, është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I “Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike”, “Përgjegjësia e Nëpunësve autorizues të të gjithë niveleve të njësisë publike dhe menaxherëve të tjerë”.

Drejtnesit e shoqërisë nuk kanë përcaktuar e miratuar rregullat specifike, procedurat standard dhe gjurmën e auditit, për dokumentimin, ruajtjen dhe qarkullimin e aktiveve.

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të shoqërisë dhe Dega e Financës, të përcaktojnë rregullat dhe procedurat për dokumentimin dhe qarkullimin e mallrave të furnizuara nga projekti, të ngrenë komisionet përkatëse për verifikimin e faturave me sasi të furnizuara me qëllim evidentimin dhe inventarizimin e saktë të tyre, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Vazhdimisht

8. Dega e financës ka pasqyruar në bilancin provizor të vitit 2014, në postin II. 2 Aktivet afatgjata, “Aktivet materiale në proces” vlerën 2,369,806,256 lekë, e rritur për vitin 2014 sipas bilancit provizor në 2,898,755,037 lekë, duke përfshirë vlerën e gjithë faturave të materialeve, pajisjeve, mjeteve të transportit dhe punimeve, të cilat nuk janë klasifikuar sipas natyrës dhe llojit, si edhe nuk është bërë ndarja në klasa për pasqyrimin dhe llogaritjen e normave të amortizimit, etj, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Për këtë rekomandojmë:

Dega e Financës, të pasqyrojë menjëherë në bilancin e 3-mujorit të parë të vitit 2015, vlerën e mjeteve të transportit, vlerën e materialeve, shërbimeve, punimeve, etj, të furnizuara nga projekti, duke i klasifikuar sipas natyrës, llojit dhe ndarjes në klasa, si edhe të kryej llogaritjet për normat e amortizimit sipas legjislacionit në fuqi, që nga momenti i furnizimit dhe vënies në punë të tyre.

Brenda muajit mars 2015

9. UKSH nuk ka caktuar një njësi koordinimi të projektit brenda stafit të UKSH, dhe nga verifikimet në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton se këtë rol e ka kryer znj. Sabahet Vidhaj Ish Drejtore e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër në kundërshtim me rregullat e përcaktuara të marrëveshjes për Projektin “Furnizimi me ujë dhe mbrojtja e liqenit të Shkodrës” (“Projekti”) ndërmjet KfW-së dhe ndërmarrjes së furnizimit me ujë UK Shkodër (UKS) dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave, veprimi mësipërm ngarkon me përgjegjësi znj. Ish Drejtore e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër për periudhën 24.02.2009 deri në 15.02.2013, dhe z. Drejtor Ujësjetllës Kanalizime Shkodër për periudhën 15.02.2013 e në vazhdim.

Për këtë rekomandojmë

UKSH të marrë masa për të zbatuar termat e përcaktuara në kreun II “Implementimi i Projektit”, paragrafi i fundit, siç përcaktohet në marrëveshjen për Projektin “Furnizimi me ujë dhe mbrojtja e liqenit të Shkodrës” (Projekti) ndërmjet KfW-së dhe ndërmarrjes së furnizimit me ujë UK Shkodër (UKS) dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave.

Brenda muajit prill 2015

10. Furnizimi i qytetit të Shkodrës me ujë të pijshëm nuk është ende në nivel të kënaqshëm. Një pjesë e qytetit ka furnizim me ujë 24 orë pa ndërprerje, ndërsa problematike paraqiten zonat që furnizohen nga linjat fundore.

Norma e arkëtimit për vitin 2014 paraqitet në nivele të ulëta rreth 68%. Niveli i lartë i debitorëve lidhet me faktin që nuk ka qenë e mundur ndërhyrja me ndërprerje të furnizimit me ujë të klientëve debitorë.

Për këtë rekomandojmë:

Të merren masa për instalimin e matësve për kategorinë “klientë familjarë”, evidentimin dhe ndjekjen e arkëtimeve të klientëve debitorë, si edhe për rastet abuzive të ndërpriten lidhjet me rrjetin e furnizimit, me qëllim rritjen e nivelit të arkëtimeve.

Vazhdimisht

11. Dosjet e tenderave të realizuara gjatë zbatimit të Projektit “Furnizimi me ujë dhe mbrojtja e liqenit të Shkodrës”, janë të painventarizuara në kundërshtim me ligjin nr. 9154, date 6.11.2003 për arkivat.

Për këtë rekomandojmë

UKSH të marrë masa për inventarizimin e dosjeve të prokurimit të Projektit “Furnizimi me ujë dhe mbrojtja e liqenit të Shkodrës”, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 për arkivat.

Brenda muajit prill 2015

12. UKSh aplikon tarifat e miratuara nga ERRU prej datës 19.12.2011. Për vitin 2014 nuk është aplikuar pranë ERRU, për rritjen e tarifës me qëllim rritjen e të ardhurave.

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të shoqërisë, të marrin masa për azhurnimin me tarifat e reja, duke aplikuar për rritjen e tarifës në ERRU, me qëllim rritjen e të ardhurave në funksion të shërbimit të ofruar.

Brenda muajit maj 2015

13. Në bazë të vlerësimeve dhe matjeve të realizuara nga specialistët e kompanisë, rezulton se rreth 40 % e ujit të prodhuar humbet në Komunën Rrethina, zona ku shtrihen tubacionet kryesore të transmetimit të ujit të pijshëm për në qytetin e Shkodrës. Këto humbje rezulton se shkaktohen nga lidhjet e paligjshme në tubacionet kryesore, duke cenuar në këtë mënyrë furnizimin me ujë të qytetit të Shkodrës dhe cilësinë e ujit të pijshëm.

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të shoqërisë, të marrin masa për ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme, me qëllim reduktimin e humbjeve dhe rritjen e të ardhurave. Për këtë qëllim, të kërkohet edhe mbështetja e Bashkisë Shkodër.

Vazhdimisht

14. Për realizimin e shërbimeve të konsulencës pjesë e pagesës është edhe vlera 57,120 Euro, e cila përfaqëson zërin “të rimbursueshme” për shërbime zyre dhe transporti, të cilat në asnjë rast nuk janë vërtetuar me faturat apo kontratat të cilat vërtetojnë realizimin e vlerës në sasi dhe kohë.

Për këtë rekomandojmë:

SHA “Ujësjellës-Kanalizime, Qytet” Shkodër, të kërkojë nga Mbikëqyrësi i punimeve, plotësimin e dokumentacionit të pagesave me dokumentacionin e nevojshëm të realizimit të shërbimeve, kryesisht për ato të rimbursueshme, udhëtime jashtë vendi, transport lokal dhe shpenzime qiraje. Pagesa e këtyre shërbimeve të reflektohet sipas shpenzimeve të kryera në faturat përkatëse.

Brenda muajit prill 2015

15. Nga auditimi i zbatimit të kontratave ka rezultuar se, për punimet e kërkuara shtesë kontrate dhe çmimet respektive të materialeve të ndërtimit, nuk janë kërkuar dhe paraqitur tre oferta nga operatorë të ndryshëm. Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzuesin e prokurimeve të KfW, pikën 3.4 “Kuotimi i çmimeve”.

Për këtë rekomandojmë:

SHA “Ujësjellës-Kanalizime, Qytet” Shkodër, të marrë masa për ndjekjen e kontratave të konsulencës dhe punimeve civile. Gjithashtu, për materiale të cilat bëhen të domosdoshme gjatë zbatimit të kontratave, të ndiqen procedurat e prokurimit, në përputhje me Pikën 3.3 të Udhëzuesit të Prokurimeve të Bankës KfW.

Gjatë zbatimit të projektit

16. Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesave të kësaj kontrate rezulton se nga furnizimi i pranuar nuk janë vendosur 4500 sahatë matës. Një pjesë e mirë e klientëve të cilët duhet të pajiseshin me këto matës, ngelen jashtë skemës së faturimit.

Bazuar në urdhër ndryshimin nr. 4, është vendosur që kontraktori të blejë 3800 kontravalvola, për arsye të dëmtimit të matësve të ujit, si pasojë e rikthimit të ujit të nxehtë nga banesat. Pa vendosur asnjë nga këto materiale, sipas urdhër ndryshimit nr. 7, është vendosur blerja e 6200 copëve të tjerë kondravalvula. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se materiali si më sipër është gjendje në magazinë, pra nuk është vendosur asnjë.

Për këtë rekomandojmë:

SHA “Ujësjellës-Kanalizime, Qytet” Shkodër, të marrë masa për vënien në përdorim të materialeve të furnizuara sipas kontratës së vendosjes së sahatëve matës, me synim rritjen e numrit të abonentëve që hyjnë në skemën e furnizimit me ujë të pijshëm.

Brenda muajit maj 2015

17. Është përfituar pagesë për shërbime konsulente me vlerë 46,390 Euro, me argumentin e mungesës së stafit teknik. Ky aspekt ka të bëjë me burimet teknike të kufizuara të SHA “Ujësjellës-Kanalizimeve” Shkodër. Nga ana e konsulentit pretendohet se janë krijuar vonesa në miratimin e çështjeve teknike dhe administrative, janë krijuar vonesa në implementimin e projektit si pasojë e mungesës së njësisë së zbatimit të projektit, ndër të tjera edhe për grumbullimin e të dhënave, marrëdhëniet me Bashkinë etj.

Për këtë rekomandojmë:

Për menaxhimin sa më të saktë të Projektit “Furnizimi me ujë dhe mbrojtja mjedisore e liqenit të Shkodrës”, Drejtori SHA “Ujësjellës-Kanalizime, Qytet” Shkodër, të marrë masa për angazhimin e stafit teknik në mbështetje të zbatimit të projektit.

Gjatë zbatimit të projektit

18. Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Furnizim me ujë dhe kanalizimet, Shkodër”, është konstatuar se janë lënë pa realizuar një sërë linjash të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pasi nuk është bërë e mundur sigurimi i lejeve përkatëse nga Bashkia Shkodër, si administruese e rrjetit rrugor në të cilin do të rikonstruktohen apo ndërtohen këto linja.

Për këtë rekomandojmë:

SHA “Ujësjellës-Kanalizime, Qytet” Shkodër në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, të marrin masa për sigurimin e lejeve të nevojshme për zbatimin e punimeve civile sipas përcaktimeve në kontratat përkatëse.

Gjatë zbatimit të projektit

19. Urdhër ndryshimi nr. 2, është miratuar me datë 08.10.2012, me vlerë 100,000 Euro. Ndryshimi ka të bëjë me ndërtimin e rezervuarit të ndërmjetëm. Në pikën 6, të Memorandumit është përshkruar se, Kontraktori do të realizojë vizatime për ndërtimin e rezervuarin e ndërmjetëm, kostoja e të cilit nuk duhet të kalojë 635,000 Euro. Ky memorandum është bërë pjesë e kontratës. Ndryshimi i pranuar është shoqëruar edhe me zvogëlim të sasisë së punimeve të parashikuara me 3,234,249.6 Euro. Ky ndryshim bie në kundërshtim me Memorandumin e mirëkuptimit të datës 14.06.2011, për këtë arsye, Kontraktori duhet t'a realizojë rezervuarin sipas vlerës së pranuar. Deri në momentin e auditimit nuk rezultojnë pagesa për këtë zë punimi.

Për këtë rekomandojmë:

SHA "Ujësjellës-Kanalizime, Qytet" Shkodër, të kërkojë nga Kontraktoripërfundimin e rezervuarit të ndërmjetëm me vlerë 635,000 Euro siç është përcaktuar në memorandumin e mirëkuptimit, memorandum i cili është bërë pjesë e kontratës së nënshkruar, dhe jo me vlerë 735,000 Euro, ndryshuar sipas urdhër ndryshimit nr. 2, datë 08.10.2012, në të kundërt vlera 100,000 Euro do të konsiderohet dëm ekonomik.
Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Nga auditimi rezulton se, për materialet përbërëse të 1 m³ llaç i përzier është llogaritur më shumë çmimi 276.8 Euro. Përlllogaritjet kanë mangësi si nga përcaktimi i sasisë së përbërësve, ashtu edhe nga çmimi i ekzagjeruar për të. Llogaritja e analizës së kostos për materialin llaç i përzier është edhe në kundërshtim me manualin e çmimeve të ndërtimit. Për prodhimin e 1 m³ llaçi të përzier në periudhën e llogaritjeve është çmimi 4843 lekë për m³, ose 34.6 Euro. Si pasojë e këtij veprimi, nga Kontraktoriështë përfituar padrejtësisht vlera 40,647.8 Euro.

Nga përlllogaritjet, referuar çmimit të furnizimit të këtyre kutive me karakteristika të ngjashme, rezulton se si pasojë e këtij veprimi nga Kontraktori është përfituar padrejtësisht vlera 43,477.8 Euro (trajtuar më hollësisht në faqet 36-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

SHA "Ujësjellës-Kanalizime, Qytet" Shkodër, të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të arkëtuar shumën 84,125.6 Euro, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori....., për punime të pa realizuara dhe likuiduara, si dhe furnizim të pajisjeve në kundërshtim me specifikimet teknike si më poshtë:

Me vlerë 40,647.8 Euro, për përlllogaritje të gabuara të analizës së çmimit për materialin llaç suvatimi.

Me vlerë 43,477.8 Euro, për furnizim të kutive të sahateve matës, pa respektuar specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Menjëherë

2. Në urdhër ndryshimi nr. 2, datë 12.10.2012 përcaktohet se kontraktori....., ka paraqitur disa pretendime për vonesa në realizimin e kontratës. Argumentimet për vonesat janë paraqitur në një periudhë rreth 17 muaj pas përfundimit të afatit të parashikuar për përfundimin e kontratës, në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të kontratës (FIDIC), Neni 20.1, Par. 1, 2. Po ashtu, argumentimet e paraqitura nuk justifikojnë shtyrjen e afatit të furnizimit, pasi janë në përgjegjësinë e kontraktorit. Pavarësisht sa më sipër, nga ana e SHA

“Ujësjiellës-Kanalizimeve, Qytet” Shkodër është përcaktuar se një automjet dhe dy mekanizma janë furnizuar me vonesë nga 51 deri në 145 ditë.

Bazuar në seksionin nr. 1, të dokumenteve të tenderit, Pika 7.4, Kontraktoripër mos zbatimin e kontratës në afatin e përcaktuar duhet të penalizohet me vlerën 78,049.7 Euro (trajtuar më hollësisht në faqet 39-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

SHA “Ujësjiellës-Kanalizime, Qytet” Shkodër të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të arkëtuar shumën 78,049.7 Euro nga Kontraktori....., si penalizim i pa aplikuar për mos realizimin e furnizimit brenda afatit kohor të parashikuar në kontratë.

Menjëherë

3. Nga ana e Kontraktorit është paraqitur pretendimi për dimensionin e tubave për tubat me diametër 90 mm, pretendohet se ato janë 110 mm dhe për tubat me diametër 160 mm, pretendohet se janë 180 mm. Ky pretendim është marrë në konsideratë edhe pse është paraqitur shumë kohë pas identifikimit, duke rritur vlerën e kontratës. Për paqartësi të dokumenteve të tenderit, kontraktori i jepet mundësia gjatë fazës së prokurimit, siç edhe ka ndodhur për paqartësi të tjera. Marrja në konsideratë e pretendimit bie në kundërshtim me Pikën 20.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC.

Rritja e çmimit për tubacion 90 mm është 27,109.4 Euro, ndërsa për tubacioni 160 mm është 19,424.2 Euro. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, rezulton se pagesa e mësipërme nuk është reflektuar ende (trajtuar më hollësisht në faqet 32-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

SHA “Ujësjiellës-Kanalizime, Qytet” Shkodër, të marrë masa për vlerësimin dhe mos përfshirjen në pagesën e Kontraktorit të vlerës 46,533.6 Euro, marrë në konsideratë si pretendim për dimensionet e disa tubave, si më poshtë:

Me vlerë 19,424.2 Euro për tubacion me diametër 160 mm;

Me vlerë 27,109.4 Euro për tubacion me diametër 90 mm.

Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve progresive

C. MASA DISIPLINORE

I. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, me ndryshimet e mëvonshme, i **kërkojmë Këshillit Mbikëqyrës të SHA “Ujësjiellës-Kanalizimeve, Qytet” Shkodër të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:**

“Vërejtje”, për:

z....., me detyrë Drejtor i SHA “Ujësjiellës-Kanalizime, Qytet” Shkodër, sepse:

- Nuk ka marrë masa për ngritjen e një njësie koordinimi të projektit brenda stafit të UKSH. Këtë rol e ka kryer znj. Ish Drejtore e Ujësjiellës Kanalizime Shkodër dhe më pas z....., në kundërshtim me rregullat e përcaktuara të marrëveshjes për Projektin “Furnizimi me ujë dhe mbrojtja e liqenit të Shkodrës” (“Projekti”) ndërmjet KfW-së dhe ndërmarrjes së

furnizimit me ujë UK Shkodër (UKS) dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave.

- Nuk ka marrë masa për përcaktimin e miratimit të rregullave specifike, procedurave standard dhe gjurmën e auditit, për dokumentimin, ruajtjen dhe qarkullimin e aktiveve.

- Nuk ka marrë masat përkatëse për ngritjen e komisioneve të marrjes në dorëzim dhe bërjen hyrje në shoqëri të automjeteve, mekanizmave dhe materialeve të ndryshme të furnizuara nëpërmjet projektit, në shumën 2,898,755 mijë lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I “Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike”.

- Gjatë zbatimit të Kontratës së punimeve civile “Furnizimi me ujë dhe kanalizimet”, ka miratuar Urdhër ndryshimin nr. 14, me vlerë 39,099.04 Euro. Ndryshimi ka të bëjë me dimensionin e tubave të pa sqaruar në dokumentet e tenderit. Marrja në konsideratë e këtij pretendimi bie në kundërshtim me Pikën 20.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC.

- Gjatë zbatimit të Kontratës së punimeve civile “Furnizim vendosje sahatë matës” ka miratuar urdhër ndryshimet nr. 4 dhe nr. 7, për blerje të 10,000 kontravalvola, për arsye të dëmtimit të matësve të ujit, të cilat nuk janë vënë në përdorim duke rritur stokun e materialeve në magazinën e Shoqërisë.

Blerja e këtyre materialeve me vlerë 46,527 Euro, pa realizuar procedurë të rregullt prokurimi, është në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimeve të Bankës KfW, Pika 3.3.

II. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, me ndryshimet e mëvonshme, si dhe në nenin 11, Paragrafi 3, të kontratës individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të SHA “Ujësjellës-Kanalizimeve, Qytet” Shkodër, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

***“Paralajmërim për pushim nga puna”, për:
znj....., me detyrë ekonomiste, sepse:***

- Ka lejuar qarkullimin e aktiveve të furnizuara nëpërmjet projektit pa u bërë hyrje me dokumentacionin e nevojshëm financiar, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

- Ka pasqyruar në bilancin e vitit 2013, në postin II. 2 Aktivët afatgjatë, “Aktivët materiale në proces” vlerën 2,369,806 mijë lekë, e rritur për vitin 2014 sipas bilancit provizor në 2,898,755 mijë lekë, duke përfshirë vlerën e gjithë faturave të materialeve, pajisjeve, mjeteve të transportit dhe punimeve, të cilat nuk i ka klasifikuar sipas natyrës dhe llojit, si edhe nuk ka bërë ndarjen në klasa për pasqyrimin e normave të amortizimit, etj, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Artan Topjana, Mimoza Bedini dhe Jorida Zhegu, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Ilizai, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.